



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1290/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Afrim Shamolli kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Lipjan nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, me numër Anr.1116/2013 të datës 06.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2013, mori këtë:

VENDIM

- I. **Refuzohet** si i pabazuar apeli nga Afrim Shamolli kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Lipjan nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK).
- II. **Bëhet përmirësimi i vendimit të ankimuar**, Anr.1116/2013 i datës 06.12.2013, ashtu që në pasuesin e 3 (tretë), largohen fjalët, “QV-2728B/01Q, QV-2710B/02R,03R2711B/01R,02R, QV-2702B/03R, si dhe dëshmitar Egzon Gecin”, në vend të tyre vendosen: “QV1302E/01/03/04, QV1303E/04, QV1304E/01/02/03, QV1305E/01, QV1306E/03, 1307E/02/03/06, 1317E, 1322E/02, 1323E/01/02/03, 1324E/01/03, 1325/02/03, 1327E/01/02, 1330E/01 dhe 1331/01 si dhe Lipjani 1 dhe Lipjani 2”, pjesa tjetër e vendimit të lartcekur mbetet i pandryshuar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel nga Afrim Shamolli kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal të Lipjanit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), me datën 11.12.2013 për rishikim të vendimit Anr. 1116/2013 të datës 06.12.2013, në të cilën pretendon se nuk është i kënaqur me vendimin e lëshuar nga PZAP-i, që është hedhur si e parregullt ankesa e tij, si edhe qendrat e votimit QV-2728B/01Q, QV-2710B/02R,03R2711B/01R,02R, QV-2702B/03R, nuk janë qendrat që parashtruesi i ankesës i ka cekur në ankesë dhe nuk ka cekur dëshmitarë të cilat janë cekur në vendim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj apelin gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se apeli ndaj vendimit në fjalë është i pabazuar ngase parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë që do të bënte të besueshme dhe që do të vërtetonte pretendimet e tilla të parashtruara në apel, andaj PZAP-i në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118.4 të LZP-së, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Meqenëse parashtruesi i apelit ka theksuar se janë shqyrtuar tjera Qendra te Votimit nga ato te cilat ishin ne ankesën Anr. 1116/13 te datës 03.12.2013, u bë përmirësimi i vendimit te ankimuar si në pikën **II** të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1290/2013 më datën 13.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.